



MBRONI Ushqimet, Bimët, dhe Kafshët tona

Çfarë e rrezikon Kanadanë?

Ushqime, bimë, kafshë dhe nënprodhime të tyre që sillen nga vende të tjera mund të sjellin në Kanada sëmundje, insekte të dëmshme dhe viruse. Ato mund të rrezikojnë kafshët, bimët dhe mjedisin ku këto zhvillohen në Kanada.

Edhe artikuj që mund t'iu duken të padëmshme (si dru të gdhendur apo fruta) mund të mbartin insekte që mund t'i shkaktojnë dëme të konsiderushme pyjeve dhe bujqësisë kanadeze.

Mishi e prodhime të tjera shtazore mund të përhapin avian influenza ("gripin e shpendëve") ose sëmundje të tjera të kafshëve që rrezikojnë të ndikojnë mbi bujqësinë, sigurinë e ushqimit dhe madje edhe vetë shëndetin e njeriut.

Bazuar në këto rreziqe janë vënë edhe kufizime mbi llojet e prodhimeve që mund të sillni në Kanada.

Roli juaj

Para se të Largoheni nga Kanadaja

- Njihuni me listën e prodhimeve që lejohen të sillen nga vendet që do të vizitoni
- Vizitoni faqen "Ndërgjegjësohuni e Deklaroni!" në internet në adresën www.BeAware.gc.ca
- Nëse keni në plan të sillni në Kanada sende të ndaluara, kërkoni paraprakisht leje importi Agjencisë Kanadeze të Kontrollit të Ushqimit (CFIA).



Kur hyni në Kanada

- Deklaroni gjithë ushqimet, bimët, kafshët dhe nënprodhimet e tyre. E kërkon ligji.
- Plotësoni kartën e deklaratës së Agjencisë së Shërbimeve të Kufirit të Kanadasë. Sigurohuni që të plotësoni në kartë pjesët në lidhje me vizitat në ferma jashtë shtetit.
- Nëse gjatë udhëtimit jashtë shtetit keni vizituar ndonjë fermë apo keni pasur kontakte me shpendë të egra, shmangiuni për 14 ditë vizitave në ferma, kopshte zoologjike, apo parqe kanadeze me kafshë të egra. Dezinfektoni këpucët e përdorura në fermë apo kur patët kontakt me shpendët e egra. Gjithashtu, lani mirë teshat dhe thajini në temperaturë të lartë.

Ligji iu detyron të deklaroni

Ligji kërkon të deklaroni sa herë hyni në Kanada gjithë ushqimet, bimët, kafshët dhe nënprodhimet e tyre.

Mosdeklarimi mund të çojë në:

- konfiskim të prodhimeve
- gjobë deri në 1300 dollarë për çdo artikull të pa deklaruar
- ndjekje penale

Kanadaja përdor qen të stërvitur posaçërisht dhe një mori mjetesh të tjera për të zbuluar prodhime të caktuara që udhëtarët mund të sjellin në vend.

Në disa aeroporte janë vendosur kosha ku mund të hidhen artikujt e ndaluar, pa ndëshkim, para se të raportoni në Agjencinë e Shërbimeve të Kufirit të Kanadasë.

Çfarë prodhimesh mund të sillni në Kanada?

Mbani përgjegjësi për t'ju njohur me listën më të fundit të sendeve të ndaluara përpara se të udhëtoni.

Për të dhëna rreth kufizimeve ndaj prodhimeve ushqimore, bimore, kafshëve apo nënprodhimeve të tyre që dëshironi të sillni në Kanada, vizitoni www.BeAware.gc.ca ose lidhuni me telefon me Shërbimin e Informacionit të Kufirit (BIS):

- Brenda Kanadasë, BIS mund të kontaktoni pa pagesë në numrin 1-800-461-9999 (TTY : 1-866-335-3237).
- Nga jashtë Kanadasë, telefononi 204-983-3500 ose 506-636-5064 (do të aplikohen tarifa interurbane).

Shembuj artikujsh të ndaluar që mund të jeni duke transportuar:



Mish dhe prodhime mishi



Krem, qumësht, djathë dhe prodhime të tjera bulmeti



Bimë, pemë dhe lule të prera



Dru dhe prodhime druri



Fruta dhe perime



Nënprodhime kafshësh



Kafshë shtëpiake, zogj dhe kafshë të tjera të gjalla



Të gjithë artikujt që mbartin dhë